

FJALA E DEPUTETIT GAZMENT BARDHI

E ENJTE 23 QERSHOR 2022

Të dashur bashkëqytetarë,

Sot krahu i majtë i kësaj salle, deputetët e Partisë Socialiste, janë udhëzuar nga partia të votojnë kundër ngritjes së komisionit hetimor për investimet strategjike. Në çdo vend demokratik vepron parimi që Kuvendi miraton ligjet, qeveria i zbaton ligjet dhe Kuvendi kontrollon mënyrën sesi qeveria ka zbatuar ligjet. Kushtetuta jonë, duke e përfytyruar Shqipërinë si një vend normal demokratik, jo vetëm parashikon ngritjen e komisioneve hetimore, por e detyron Kuvendin të ngrejë komision hetimor kur këtë e kërkojnë 35 deputetë.

Kjo është qartësuar edhe në ligjin “Për komisionet hetimore”, ku në nenin 5 të tij shprehimisht thuhet: “Komisioni hetimor krijohet me kërkesë të 35 deputetëve. Grupi nismëtar paraqet qëllimin e krijimit të komisionit, çështjen që do të hetohet, propozimin për përbërjen e komisionit dhe afatin e përafërt të përfundimit të hetimeve. Kuvendi është i detyruar ta miratojë ngritjen e komisionit hetimor”. Çfarë kemi kërkuar ne, 35 deputetë të opozitës? As më shumë dhe as më pak se një të drejtë që na e njeh Kushtetuta, të kontrollojmë mënyrën sesi qeveria ka zbatuar një ligj të miratuar nga ky parlament, ligjin “Për investimet strategjike”.

Ky është rasti tipik se kur mund të ngrihet një komision hetimor. Nëse qeveria ka zbatuar ligjin, çfarë e shqetëson që parlamenti të kontrollojë zbatimin e tij? Prej 45 ditësh shqiptarët e kanë parë Edi Ramën të gjejë justifikim pas justifikimi për të bllokuar ngritjen e këtij komisioni hetimor. Secili prej jush, të dashur bashkëqytetarë, pyet veten: çfarë e detyron Edi Ramën që të shkelë Kushtetutën, të shkelë ligjin dhe ta pengojë parlamentin të kontrollojë mënyrën se si ai dhe qeveria e tij kanë zbatuar ligjin? Përgjigjja ndodhet në këtë tabelë! (Zoti Bardhi paraqet foto.)

Kjo vlen më shumë për zonjën Spiropali, se kush janë investitorët që ju u keni dhënë të njëjtin status, si dikur, Klodian Zotos dhe Mirel Mërtirit. Janë 36 projekte, zonja Ministre, që kanë marrë statusin e investitorit strategjik me firmë të Edi Ramës, me vlerë investimi 4,6 miliardë

euro, aq sa është buxheti vjetor i shtetit shqiptar. 80% e tyre janë investimeve janë në fushën e turizmit, ku Edi Rama, pa garë, u ka vënë në dispozicion pasuritë publike, brigjet e detit dhe plazhet me të bukura në Jug të vendit.

Nëse prisni të shikoni në këtë listë ndonjë investitor të huaj, do të zhgënjeheni! 36 projekte të investimeve strategjike, me vlerë 4,6 miliardë euro, i kanë marrë jo më shumë se 10 individë, ku secili prej tyre ka 3 apo 4 projekte të përfutuara. Në këtë listë, sigurisht, mund të ketë ndonjë projekt që e meriton statusin e investitorit strategjik, por pjesa dërrmuese janë abuzive, klienteliste dhe korruptive. Kush janë përfituesit, do të thoni ju? Asnjë surprizë edhe këtu. Janë të njëjtët, ata që kanë përfituar në këta 9 vjet çdo koncesion, çdo PPP dhe çdo tender të madh nga kjo qeveri.

E vetmja shtesë në këtë listë, që është informacion i marrë nga Komiteti i Investimeve Strategjike, janë ministrja Olta Xhaçka dhe aktori Gaz Paja. Kuvendi në vitin 2015 miratoi një ligj, gjoja me sebebin se do të sillte investime të huaja dhe do të krijonte lehtësi për investitorë seriozë të huaj, por përfundimi është që përfitues nga ligji janë 10 individë, miqtë dhe ortakët e përhershëm të Edi Ramës, shtuar Olta Xhaçkën dhe Gaz Pajën. Në listë nuk mungon ndërtuesi i sarajeve personale në Surrel të Edi Ramës, Pandeli Carapuli; eksponentë të kallëzuar në SPAK për krime zgjedhore, që blenë vota për Partinë Socialiste në qarkun Shkodër, kanë shantazhuar dhe kërcënuar me jetë votuesit, si Pëllumb Gjoka; apo kompani që janë në proces likuidimi për shkak se kanë falimentuar.

Pra, ligji “Për investimet strategjike” është shndërruar nga Edi Rama në një plaçkë për të shpërblyer me pasuri publike, kryesisht me prona në bregdet, në kundërshtim me ligjin, miqtë, familjarët dhe bashkëpunëtorët e tij. Për abuzimet me këtë ligj, Edi Rama, si kryetar i Komitetit të Investimeve Strategjike, nuk mund të thotë: “Nuk dija gjë; e ka bërë ministri me kokën e vet; apo kam firmosur pa lexuar”, për abuzimet me këtë ligj përgjegjësia është direkt e Edi Ramës. Prandaj i ka urdhëruar sot deputetët e tij të bllokojnë ngrijën e komisionit hetimor.

Fakti që Edi Rama dhunon Kushtetutën dhe ligjin, duke mohuar një të drejtë kushtetuese të opozitës, është, në fakt, prova më e mirë që ai vetë, personalisht, jo vetëm është përgjegjës për abuzimet me ligjin, por është edhe arkitekti i shndërrimit të ligjit “Për investimet

strategjike” në një ligj klientelist dhe korruptiv. Sot, por edhe gjatë ditëve të shkuara, është bërë publik rasti i përfitimit të pronave publike nga ministrja për Europën dhe Punët e Jashtme dhe deputetja e PS-së, Olta Xhaçka.

Nuk do të ndalem në sqarimin e përfitimit të kësaj prone, sepse vetë ministrja e pranoi që bashkëshorti i saj ka përfituar pronë në përdorim, duke e thjeshtëzuar faktin se do të vendosë disa çadra. Në fakt, nuk do të vendosë çadra, por do të ndërtojë disa stacione plazhi, sipas vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike. Kjo, zonja Ministre, nuk është çështje vullneti apo dëshire juaja, por dhënia e pasurisë publike për qëllime fitimi dhe ushtrimi të veprimtarive fitimprurëse është bërë në shkelje flagrante të ndalimeve kushtetuese dhe ligjore. E gjithë vendimmarrja e Edi Ramës dhe institucioneve publike në këtë rast është në kundërshtim flagrant me ligjin.

Përveç nenit 70, pika 3, të Kushtetutës, që është i qartë dhe i paekuvok, ndalimi kushtetues është detajuar edhe në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Sipas këtij ligji: “Ministri nuk mund të zotërojnë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj. Për më tepër, deputetit apo ministrit dhe shoqërive tregtare që ai zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk i lejohet të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”. Këto ndalime veprojnë njëjloj, sipas ligjit, edhe për bashkëshortin e deputetit apo ministrit.

Madje, për ta bërë më të thjeshtë këtë ndalim, ligji parashikon: “Në rast se aksionet apo pjesët në kapital janë të regjistruara në emrin e bashkëshortit, ato vlerësohen njëjloj si të ishin të regjistruara në emër të vetë deputetit apo ministrit dhe bashkëshortit i kufizohen të drejtat pasurore për to në të njëjtën masë dhe mënyrë si në rastin e vetë deputetit apo ministrit”. Siç shihet, ligjet në fuqi e ndalojnë Edi Ramën t’i japë favore familjes së ministres Olta Xhaka. Pra, befas, me firmë të Edi Ramës, ministra Olta Xhaçka shndërrohet në investitore e 5,5 milionë eurove, duke përfituar pasuri publike.

Si është e mundur, zonja Ministre, që ju të investoni 5,5 milionë euro? Cili është burimi i këtyre të ardhurave? Ministrja dhe bashkëshorti i saj janë subjekt i deklarimit të pasurisë dhe pasuria e

tyre e ligjshme është publike. Ata deklarojnë një pasuri normale, madje deklarojë se kanë marrë kredi bankare për të blerë shtëpi; kanë marrë kredi bankare për të blerë automjetin me të cilin lëvizin, madje kanë marrë kredi edhe për të kryer studimet. Të ardhurat e vetme që deklarojnë janë paga e ministres, pensioni suplementar që merr bashkëshorti si ish-deputet dhe qiraja e bashkëshortit për një objekt të dhënë me qira.

E dini cila është më e bukura? “Investitor strategjik” është bërë dikush që është paguar me “pagë lufte”. Po, mos u habitni, bashkëshorti i ministres, si shtresë në nevojë, deklaroi se gjatë periudhës së COVID-it ka përfituar pagën e luftës prej 400 mijë lekë të vjetër. Ky është investitori strategjik, i cili deklaroi që është i papunë dhe “shtresë në nevojë” që ka marrë 400 mijë lekë të vjetër në periudhën e COVID-it. Vetëm me firmë të Edi Ramës mund të ndodhë që sot të jesh “shtresë në nevojë” dhe të përfitosh “pagë lufte” 400 mijë lekë të vjetër, dhe të nesërmen të gdhiesh investitor strategjik, që ke kapacitet financiar për të investuar as më shumë dhe as më pak, por plot 5,5 milionë euro.

Mund të thotë dikush, të nderuar kolegë, që mund të jenë të varfër në pasuri personale, por kompaninë mund ta kenë të pasur. E drejtë, edhe kompania, njëlloj si ministrja dhe bashkëshorti i saj, deklaroi të ardhurat në shtet çdo vit, nëpërmjet pasqyrave financiare. E dini sa të ardhura apo fitim deklaroi kompania në 5 vjet aktivitet, kjo kompania që ka marrë statusin e investitorit strategjik? As më shumë dhe as më pak, por zero të ardhura dhe fitime, madje deklaroi se ka humbje në total 40 milionë lekë. Konkretisht: 900 mijë lekë humbje në vitin 2016; 1,1 milion lekë të rinj humbje në vitin 2017; 2 milionë lekë humbje në vitin 2018; 2,6 milionë lekë humbje në vitin 2019 dhe 4 milionë lekë humbje në vitin 2020.

Pra, dikush që shtëpinë e blenë me kredi bankare, makinën me kredi bankare, studimet me kredi bankare, merr pagë lufte si shtresë në nevojë, në 5 vjet kompania që disponon deklaroi të ardhura apo fitim zero lekë, befasisht gdhiesh investitor strategjik për të investuar 5,5 milionë euro. Ku do t’i gjejë Olta Xhaçka 5,5 milionë euro? Përgjigjen e kësaj pyetje duhet t’ua japin shqiptarëve ministrja Xhaçka dhe Edi Rama. E sigurt është që opsionet e përgjigjes janë vetëm tre: ose ministrja ka fshehur pasurinë dhe nuk ka deklaruar të gjithë pasurinë që disponon; ose kompania e ministres ka fshehur të ardhurat apo fitimet dhe ka bërë evazion fiskal; ose në

projektin që Edi Rama i ka dhënë statusin e investitorit strategjik, po planifikohen të investohen paratë e korrupsionit qeveritar.

Të tria përgjigjet janë krim, që dënohen me burg. Në fakt, përgjigja e kësaj pyetje nxjerr zbuluar Edi Ramën për arsyet e vërteta, që e detyruan të dhunonte Kushtetutën, duke i mohuar opozitës të drejtën për ngritjen e një komisioni hetimor për investimet strategjike. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është i vendosur për të bërë transparencë dhe për të vënë para përgjegjësisë ligjore cilindo që ka abuzuar me ligjin dhe me pasuritë publike të qytetarëve shqiptarë. Mund ta vononi, mund ta zvarrisni, por transparencën nuk do ta ndalni dot!

Njëlloj si me inceneratorët, Edi Rama edhe sot po ju përdor, të nderuar kolegë të Partisë Socialiste! E mbani mend besoj që, për të fshehur skenën e krimit tek inceneratorët, ju mori të gjithëve dhe ju dërgoj atje si dekor për të fshehur malin me plehrat e korrupsionit ju mori të gjithëve dhe ju dërgoj atje si dekor për të fshehur malin me plehrat e korrupsionit, që doli në sipërfaqe sapo ikët ju nga aty. Ju, me imazhin tuaj, e fshehët disa ditë, por shqiptarët u njohën me faktet tronditëse se si miliona euro kishin shkuar në xhepat e ministrave, deputetëve dhe zyrtarëve publikë, ndërkohë që 3 investitorët, që Elisa i shpalli shenjtorë edhe në atë kohe, janë sot në arrati si kriminelë ordinerë.

Sot po ju detyron të votoni kundër, duke fshehur pas kartonit tuaj plaçkitjen e pronave publike me një grusht të ngushtë miqsh dhe bashkëpunëtorësh. Edhe në këtë rast kartoni juaj i kuq vetëm sa i jep karton të kuq kësaj qeverie të korruptuar, sepse llogaridhënien dhe përgjegjësinë e abuzuesve nuk do ta ndaloni dot. Faleminderit!